



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**Këshilli Gjyqësor i Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.24 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 28 të Ligjit për Gjykatat, nenit 25 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Vendimit të Këshillit KGJK. Nr. 48/2021, të datës 19 shkurt 2021, në mbledhjen e mbajtur me 29 dhjetor 2021,

**Miraton:**

**RREGULLORE 07/2021**  
**PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E**  
**VENDEVE TË PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE DHE DEGET E**  
**TYRE**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në gjykatat themelore dhe në degët e tyre.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohet nga të punësuarit në gjykatat themelore dhe në degët e tyre.

**Neni 2**

**Gjykatat Themelore**

1. Sipas Ligjit për Gjykatat, në territorin e Republikës së Kosovës janë shtatë (7) Gjykata Themelore të shkallës së parë, si në vijim:
  - 1.1. Gjykata Themelore Prishtinë, me degët në: Podujevë, Graçanicë, Lipjan, Gllogoc dhe Fushë Kosovë;
  - 1.2. Gjykata Themelore Gjilan, me degët në: Kamenicë, Viti dhe Novobërdë;
  - 1.3. Gjykata Themelore Prizren, me degët në: Dragash dhe Suharekë;
  - 1.4. Gjykata Themelore Mitrovicë, me degët në: Leposaviq, Vushtrri, Zubin Potok dhe Skenderaj;
  - 1.5. Gjykata Themelore Gjakovë, me degët në: Malishevë dhe Rahovec;
  - 1.6. Gjykata Themelore Pejë, me degët në: Istog, Klinë, Deçan dhe Junik;
  - 1.7. Gjykata Themelore Ferizaj, me degët në: Kaçanik, Han të Elezit, Shtërpcë dhe Shtime.

### **Neni 3**

#### **Organizimi i brendshëm i Gjykatës Themelore**

1. Gjykata Themelore organizohet si në vijim:
  - 1.1. Në kuadër të Gjykatave Themelore veprojnë Departamentet, si në vijim:
    - 1.1.1. Departamenti për Krimet e Rënda;
    - 1.1.2. Departamenti për të Mitur; dhe
    - 1.1.3. Departamenti i Përgjithshëm, që vepron edhe në secilën degë të Gjykatave Themelore.
  2. Në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës përveç departamenteve nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i këtij neni, veprojnë edhe departamentet e poshtëshënuara që kanë kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës;
    - 2.1. Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës;
    - 2.2. Departamenti për Çështjet Ekonomike;
    - 2.3. Departamenti për Çështjet Administrative.
3. Struktura e brendshme organizative e Gjykatës Themelore është si vijon:
  - 3.1. Zyra e Kryetarit të Gjykatës;
  - 3.2. Zyra e Administratorit të Gjykatës.
4. Numri i të punësuarve në gjykatat themelore dhe në degët e tyre përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (tutje: Këshilli) në përputhje me buxhetin vjetor dhe planin e personelit, që përfshin pozitat e gjyqtarëve dhe të punësuarve të tjerë.

### **Neni 4**

#### **Zyra e Kryetarit**

1. Zyra e Kryetarit përbëhet nga:
  - 1.1. Kryetari;
  - 1.2. Nënkryetari;
  - 1.3. Gjyqtari Mbikëqyrës;
  - 1.4. Gjyqtarët;
  - 1.5. Administratori i gjykatës;
  - 1.6. Zyrtari ekzekutiv.
2. Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionon edhe Zyra për Informim dhe Komunikim me Media.
3. Zyrtari ekzekutiv zgjedhet dhe emërohet nga Kryetari i gjykatës dhe është përgjegjës vetëm para tij, për kryerjen e detyrave të punës.
4. Kohëzgjatja e kontratës së punës së zyrtarit ekzekutiv është me afat të caktuar dhe lidhet me mandatin e Kryetarit të gjykatës, përveç nëse i njëjti lirohet nga detyra sipas kërkesës së Kryetarit apo sipas mënyrave të tjera të përcaktuara me ligj.

5. Zyrtari ekzekutiv ka të drejtën e pagesës ekuivalente me pagën e Zyrtarit Ligjor në gjykatë.

### **Neni 5 Kryetari i gjykatës**

Përveç kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në Ligjin për Gjykatat dhe legjislacionin përkatës në fuqi, Kryetari i gjykatës është përgjegjës për administrimin ditor të gjykatës, në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli.

### **Neni 6 Nënkryetari i gjykatës**

Në mbështetje të Ligjit për Gjykatat, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli, nënkryetari i gjykatës ushtron detyrat e Kryetarit të gjykatës në mungesë të tij apo kur Kryetari e ka të pamundshëm ushtrimin e detyrave të tij. Nënkryetari ushtron edhe detyra të tjera të cilat i delegohen me shkrim nga Kryetari i gjykatës.

### **Neni 7 Gjyqtari mbikëqyrës**

Përveç, kompetencave dhe përgjegjësi të parapara në Ligjin për Gjykatat dhe legjislacionin përkatës në fuqi, Gjyqtari mbikëqyrës është përgjegjës për administrimin ditor të degës së gjykatës, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli.

### **Neni 8 Gjyqtarët**

Gjyqtarët ushtrojnë funksionin e tyre në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

### **Neni 9 Zyra për Informim dhe Komunikim me Media**

1. Zyra për Informim dhe Komunikim me Media përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
  - 1.2. Zyrtar për Informim dhe Komunikim me Media;
2. Zyra është përgjegjëse për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me informimin e Mediave dhe Publikut për punët dhe aktivitetet e gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përshkrimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Kryetarit të gjykatës dhe Udhëheqësit të Zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun në Këshillin Gjyqësor.
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Kryetari në koordinim me Udhëheqësin e Zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun në Këshillin Gjyqësor.

4.1.Vlerësimi i performancës së të punësuarit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës;

#### **Neni 10**

#### **Struktura Organizative e Administratës në Gjykatën Themelore**

1. Administrata e Gjykatës Themelore përbëhet nga:

- 1.1. Zyra e Administratorit;
- 1.2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve;
- 1.3. Zyra për Mbështetje Juridike;
- 1.4. Zyra për Shërbime të Përbashkëta;
- 1.5. Zyra për Buxhet dhe Financa.

#### **Neni 11**

#### **Zyra e Administratorit**

1. Zyra e Administratorit përbëhet nga:

- 1.1. Administratori;
- 1.2. Zyrtar Certifikues;
- 1.3. Zyrtar i Personelit.

2. Përjashtimisht pozitave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë ka edhe pozitën:

- 2.1. Zëvendës Administrator; dhe
- 2.2. Zyrtar i Lartë i Personelit.

3. Administratori i gjykatës menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës, në bashkëpunim me Kryetarin dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit, si dhe është përgjegjës ndaj Kryetarit të gjykatës, për administrimin efikas dhe efektiv të gjykatës.

4. Të punësuarit e të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, si dhe paragrafin 2, i përgjigjen dhe i raportojnë Administratorit.

5. Vlerësimi i performancës së Administratorit bëhet nga Kryetari në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit.

5.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, si dhe paragrafi 2 bëhet nga Administratori.

#### **Neni 12**

#### **Zyra për Mbështetje Juridike**

1. Zyra për Mbështetje Juridike përbëhet nga:

- 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
- 1.2. Bashkëpunëtorë profesional;
- 1.3. Zyrtar Ligjor/Sekretar Juridik;
- 1.4. Zyrtar për Përkthime;
- 1.5. Përjashtimisht këtyre pozitave, Gjykata Themelore në Prishtinë ka edhe pozitën Këshilltar Profesional.

2. Zyra për Mbështetje Juridike është përgjegjëse për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin efektiv të seancave gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përshkrimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Kryetarit, ndërsa për çështje administrative Administratorit.
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës dhe gjyqtarit me të cilin punojnë;
  - 3.2. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.4 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës, bëhet nga Kryetari në koordinim me Administratorin.
  - 4.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të këtij neni bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me gjyqtarin me të cilin punojnë;
  - 4.2. Vlerësimi i performancës së të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.4 të këtij neni bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës.

### **Neni 13**

#### **Zyra për Menaxhimin e Lëndëve**

1. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
  - 1.2. Sektori për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim;
    - 1.2.1. Mbikëqyrës i Sektorit;
    - 1.2.2. Referent;
    - 1.2.3. Dorëzues;
  - 1.3. Sektori për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika;
    - 1.3.1. Mbikëqyrës i Sektorit;
    - 1.3.2. Referent;
    - 1.3.3. Arkivist i lartë;
    - 1.3.4. Arkivist;
    - 1.3.5. Zyrtari i Statistikës.
2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve është përgjegjëse për pranimin, regjistrimin, dorëzimin, menaxhimin, ekzekutimin, arkivimin dhe raportimin statistikor të lëndëve në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përshkrimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Administratorit.

- 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1 dhe nënparagrafi 1.3 pika 1.3.1 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës;
  - 3.2. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të këtij neni si dhe të punësuarit në paragrafin 1, nënparagrafi 1.3 pika 1.3.2, 1.3.3, 1.3.4 dhe 1.3.5 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Mbikëqyrësit të Sektorit.
4. Vlerësimi i performancës të Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori.
- 4.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1, dhe nënparagrafi 1.3 pika 1.3.1 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi e Zyrës;
  - 4.2. Vlerësimi i performancës i të punësuarve në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe 1.2.3 si dhe të punësuarit në paragrafin 1, nënparagrafi 1.3 pika 1.3.2, 1.3.3, 1.3.4 dhe 1.3.5 të këtij neni, bëhet nga Mbikëqyrësit e Sektorit.

#### **Neni 14** **Zyra për Shërbime të Përbashkëta**

1. Zyra për Shërbime të Përbashkëta përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqës i Zyrës;
  - 1.2. Zyrtar i Teknologjisë Informative;
  - 1.3. Operator i TV-së;
  - 1.4. Zyrtar i logjistikës;
  - 1.5. Receptonist;
  - 1.6. Personel mbështetës dhe i mirëmbajtjes siç janë: vozitës, roje sigurimi, shtëpia dhe mirëmbajtës higjiene;
  - 1.7. Përfshihen këtu pozitave, në Gjykata Themelore në Prishtinë ka edhe pozitën:
    - 1.7.1. Mbikëqyrës i Sigurimit; dhe
    - 1.7.2. Depoist.
2. Zyra për Shërbime të Përbashkëta është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative, logjistikes, transportit, sigurisë dhe higjiene, sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përkrahimit të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton administratorit të gjykatës;
  - 3.1. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, dhe 1.7 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës;
  - 3.2. Përfshihen nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të këtij neni, në Gjykata Themelore Prishtinë, ashtu që pozita e Rojës së Sigurimit i përgjigjet dhe i raporton Mbikëqyrësit të Sigurimit.
6. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori.
  - 6.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1 nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës, me

përfashtim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sa i përket pozitës Roje Sigurimi e paraparë me paragrafin 1, nën paragrafi 1.6, të këtij neni ku vlerësimin e performancës e bën Mbikëqyrësi i Sigurimit.

### **Neni 15** **Zyra për Buxhet dhe Financa**

1. Zyra për Buxhet dhe Financa përbëhet nga:
  - 1.1. Udhëheqësi i Zyrës;
  - 1.2. Zyrtar Shpenzues;
  - 1.3. Zyrtar për të Hyra;
  - 1.4. Arkëtar;
  - 1.5. Përfashtimisht këtyre pozitive, Gjykata Themelore në Prishtinë ka edhe pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa.
2. Zyra për Buxhet dhe Financa është përgjegjëse për të gjitha çështjet financiare të Gjykatës Themelore sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve të miratuara nga Këshilli dhe përfshkrimin të detyrave të punës.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përfjegjet dhe i raporton administratorit, ndërsa të punësuarit e përfcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni i përfjegjen dhe i raportojnë udhëheqësit të zyrës.
  - 3.1. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të zyrës bëhet nga Administratori;
  - 3.2. Vlerësimi i performancës së të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës.

### **Neni 16** **Dega e Gjykatës Themelore**

1. Struktura e brendshme organizative e degës së Gjykatës Themelore është si vijon:
  - 1.1. Zyra e Gjyqtarit Mbikëqyrës; dhe
  - 1.2. Zyra e Ndhmës Administratorit;

### **Neni 17** **Zyra e Gjyqtarit Mbikëqyrës**

1. Zyra e Gjyqtarit Mbikëqyrës përbëhet nga:
  - 1.1 . Gjyqtari Mbikëqyrës;
  - 1.2 . Gjyqtarët; dhe
  - 1.3 . Ndhmës Administratori i Degës.

### **Neni 18** **Struktura Organizative e Administratës në degën e Gjykatës Themelore**

Administrata e degës së Gjykatës Themelore përbëhet nga zyra e Ndhmës administratorit.

### **Neni 19** **Zyra e Ndhmës Administratorit**

1. Zyra e Ndhmës administratorit përbëhet nga:

- 1.1. Ndhmës administratori;
  - 1.2. Bashkëpunëtor profesional;
  - 1.3. Zyrtar ligjor / Sekretar juridik;
  - 1.4. Referent;
  - 1.5. Zyrtar i Teknologjisë Informativë;
  - 1.6. Zyrtar për përkthime;
  - 1.7. Zyrtar për të hyra/Arkëtar;
  - 1.8. Arkivist;
  - 1.9. Receptionist; dhe
  - 1.10. Personel mbështetës dhe i mirëmbajtjes siç janë: vozitës, dorëzues, roje sigurimi, shtëpiak/depoist dhe mirëmbajtës higjiene.
2. Ndhmës administratori i degës së gjykatës, menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të degës, në bashkëpunim me Gjyqtarin Mbikëqyrës dhe në koordinim me Kryetarin dhe Administratorin e Gjykatës Themelore dhe është përgjegjës ndaj Gjyqtarit Mbikëqyrës për administrimin efikas dhe efektiv të gjykatës.
  3. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të këtij neni i përgjigjen dhe i raportojnë gjyqtarit me të cilin punojnë dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës.
  4. Të punësuarit e përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafi 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 dhe 1.10 të këtij neni, i përgjigjen dhe i raportojnë Ndhmës Administratorit.
  5. Vlerësimi i performancës së Ndhmës Administratorit bëhet nga Gjyqtari Mbikëqyrës në koordinim me Administratorin.
    - 5.1. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, bëhet nga Gjyqtarit Mbikëqyrës në koordinim me gjyqtari me të cilin punojnë;
    - 5.2. Vlerësimi i performancës së të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 dhe 1.10 të këtij neni, bëhet nga Ndhmës Administratori.

## **Neni 20**

### **Organogramet**

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore janë Organogramet e Gjykatave Themelore dhe të degëve të tyre, si në vijim:
  - 1.1. Shtojca 1: Organogrami i Gjykatës Themelore Prishtinë, me degët: Podujevë, Graçanicë, Lipjan dhe Gllogoc;
  - 1.2. Shtojca 2: Organogrami i Gjykatës Themelore Gjilan, me degët: Kamenicë, Viti, dhe Novobërdë;
  - 1.3. Shtojca 3: Organogrami i Gjykatës Themelore Prizren, me degët e saj në Dragash dhe Suharekë;
  - 1.4. Shtojca 4: Organogrami i Gjykatës Themelore Mitrovicë, me degët: Leposaviq, Vushtrri, Zubin Potok dhe Skenderaj;
  - 1.5. Shtojca 5: Organogrami i Gjykatës Themelore Gjakovë, me degët: Malishevë dhe Rahovec;
  - 1.6. Shtojca 6: Organogrami i Gjykatës Themelore Pejë, me degët: në Istog, Klinë, dhe Deçan;
  - 1.7. Shtojca 7: Organogrami i Gjykatës Themelore Ferizaj, me degët: Kaçanik dhe Shtërpcë.

## **Neni 21**



## Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrje në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret e Këshillit:
  - 1.1. Rregullore Nr.05/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Prishtinë;
  - 1.2. Rregullorja Nr.06/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Gjiilan;
  - 1.3. Rregullore Nr.07/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Gjakovë;
  - 1.4. Rregullore Nr.08/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Ferizaj;
  - 1.5. Rregullore Nr.09/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Mitrovicë;
  - 1.6. Rregullore Nr.10/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Prizren; dhe,
  - 1.7. Rregullore Nr.11/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore Pejë.

### Neni 22

#### Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Sekretariati i Këshillit të gjitha pozitat e të punësuarve brenda gjykatës do t'i ndryshoj dhe harmonizoj me titujt e përcaktuar në këtë Rregullore, pa i dëmtuar në pagë.
2. Jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Sekretariati i Këshillit do të bëjë përshkrimet e detyrave të punës e të punësuarve brenda gjykatës, sipas titujve të përcaktuar me këtë Rregullore.

### Neni 23

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.




Albert Zogaj

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës


Datë: 31. 12. 2021

# ORGANOGRAMI I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË DHE DEGËT






# ORGANOGRAMI I GJYKATËS THEMELORE NË PRIZREN DHE DEGËT



# ORGANOGRAMI I GJYKATËS THEMELORE NË MITROVICË DHE DEGËT





# ORGANOGRAMI I GJYKATËS THEMELORE NË PEJË DHE DEGËT

